

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**PËRPUNIM DRURI**

**Niveli III**  
**(1 vjeçar)**

**Kodi:C-III-12**

Miratoi:

**MINISTRI**

**MYQEREM TAJAJ**

**Tiranë, 2012**



## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.
3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.

**III. Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III, është *zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin e drurit, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III. kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit II të drejtimin mësimor “Përpunim druri”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të kryejë interpretimin, plotësimin dhe përgatitjen e dokumentacionit që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të zbatojë standardet teknike (ISO) në fushën e përpunimit të drurit.
- Të zbërthejë planorganizimin e punimeve në repart ose fabrikë të përpunimit të drurit.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve në repartin e punës.
- Të kryejë zbërthimin dhe përpunimin e fletëve të vizatimit të planimetrisë së repartit të punës.
- Të kryejë zbërthimin dhe përpunimin e fletëve të vizatimit të objekteve prej druri.
- Të zbërthejë skemat e punës të pajisjeve, makinave, linjave konvejer në fabrikat e përpunimit të drurit.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve përgatitore në prodhimin e objektit prej druri.
- Të përgatitë makinën nga ana teknike dhe e sigurisë.
- Të punojë në makina të kompjuterizuara të përpunimit të drurit.
- Të ndjekë zbatimin e punimeve të realizimit të objektit prej druri.
- Të kryejë punime speciale në poste pune të repartit, si përcaktime të vetive të drurit dhe prodhimeve gjysmë të gatshme.
- Të ndjekë zbatimin e rregjimeve në procese të ndryshme të prodhimit, gjatë trajtimit hidro-termik, termik të drurit, presimit, tharjes, defibrimit etj.

- Të ndjekë realizimin e recetave të përgatitjes së kimikateve që përdoren, si lëndët ngjitëse, hidrofuge, ilustruese, ngjyruese, imprenjuese etj.
- Të bashkëpunojë për zbatimin e punimeve të instalimeve të makinave, linjave dhe të transportit të brendshëm etj.
- Të hartojë dhe të plotësojë dokumentacionin teknik në repart.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit (AUTOCAD dhe programe llogaritëse për preventivin).
- Të bashkëpunojë për evidentimin dhe kualifikimin e punëtorëve në repart ose fabrikë.
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e instrumenteve, veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës në mjediset përkatëse.
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### **4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtëjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e teknikut të përpunimit të drurit.

Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në të gjitha bizneset e përpunimit dhe shërbimit të drurit, në nivelin e teknikut për ndjekjen e proceseve të punës, në pikat e tregëtimit të objekteve prej druri dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e përpunimit të drurit.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.

Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri”, niveli III.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/17</b> (510/578)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2
2		Gjuhë e huaj	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)
4		Histori	2
5		Gjeografi	2
6		Matematikë	2
7		Biologji	2
8		Teknologji informimi e komunikimi	1
9		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti)	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>9 (306)</b>
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-09-265-12	Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit	1
4	L-26-266-12	Përdorimi i <i>AutoCAD-2D</i> në përpunimin e drurit	1
5	L-09-267-12	Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti.	2
6	L-09-268-12	Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brëndshëm	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>6 (204)</b>
1	M-09-810-12	Zbërthimi i projektit të objekteve me bazë druri.	33
2	M-09-811-12	Ndjekja e punimeve për ngritjen e repartit të përpunimit të drurit.	33
3	M-09-812-12	Ndjekja e punimeve për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.	69
4	M-09-813-12	Ndjekja e procesit të tharjes së lëndës së parë me bazë druri.	36
5	M-26-814-12	Vizatime teknike të përpunimit të drurit me <i>AutoCAD</i>	33
		Gjithsej A+B+C	<b>30/32</b> (1020/ 1088)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli III, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Përpunim druri”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Përpunim druri”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASH.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli III.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut të përpunimit të drurit, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 13 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin i saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
<b>Tema 3</b>	Aftësitë menaxheriale	8 orë
<b>Tema 4</b>	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
<b>Tema 5</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore	7 orë
<b>Tema 6</b>	Menaxhimi i informacionit	6 orë
<b>Tema 7</b>	Menaxhimi marketing	5 orë
<b>Tema 8</b>	Menaxhimi financiar	9 orë
<b>Tema 9</b>	Zhvillimi i një plani biznesi	7 orë
<b>Tema 10</b>	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
<b>Tema 11</b>	Kuadri ligjor dhe taksat	5 orë

## 2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 34 orë

### • Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 34 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	4 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
<b>Tema 10</b>	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

## 3. Lënda “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”( L-09-265-12). Kl. 13 – 34 orë

### • Synimet e lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl.13 nxënësit duhet:

- Të njohin ligjshmërinë në vendosjen e repart / fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës të banuar.
- Të njohin ligjshmërinë në mbrojtje të shëndetit të puntorëve në fushën e përpunimit të drurit.
- Të njohin strukturën e një biznesi sipas llojit të objektit prej druri që prodhon.
- Të njohin ligjshmërinë për marrëdhëniet sipërmarrës - investitor – klient në fushën e

përpunimit të drurit.

- Të interpretojnë planorganizimin e punimeve të vendosjes së repartit / fabrikës me anekset përkatëse në përpunimin e drurit.
- Të njohin dokumentacionin teknik të punimeve sipas fazave të prodhimit të objekteve prej druri (kohëshënuesi, bordero, tabela e magazinës së repartit, e zberthimit të kostos, procesverbale, etj.
- Të hartojnë preventivin përfundimtar të objektit prej druri.
- Të plotësojnë për lloje punimesh dhe situata të posacme procesverbalet dhe formularët përkatës.
- Të njohin dhe të plotësojnë dokumentacionin teknik në përfundim të punimeve në makineri, montim etj. të objektit prej druri ose prodhime gjysmë të gatshme.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në përpunimin e drurit”, kl.13 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Njohuri për ligjet urbanistike për vendndodhjen e repartit / fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës të banuar.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për ligjet në mbrojtje të shëndetit të punëtorëve në fushën e përpunimit të drurit	3 orë
<b>Tema 3</b>	Njohuri për strukturën e një biznesi të përpunimit të drurit.	4 orë
<b>Tema 4</b>	Njohja e ligjshmërisë për marrëdhëniet sipërmarrës-investitor-klient në përpunimin e drurit.	4 orë
<b>Tema 5</b>	Planorganizimi i vendosjes së repartit /fabrikës dhe anekset përkatëse	6 orë
<b>Tema 6</b>	Dokumentimi teknik i punimeve të përpunimit të drurit	8 orë
<b>Tema 7</b>	Dokumentimi teknik për përfundimin e punimeve të përpunimit të drurit	5 orë

**4. Lënda “Përdorimi i *AutoCAD-2D* në përpunimin e drurit” (L-26-266-12). Kl. 13 – 34 orë**

• **Synimet e lëndës “Përdorimi i *AutoCAD-2D* në përpunimin e drurit”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përdorimi i *AutoCAD-2D* në përpunimin e drurit kl.13, nxënësit duhet:

- Të njohin programin e *AutoCAD-2D* që përdoret në përpunim druri për hartimin e skicave dhe fletëve të projektit.
- Të njohin menunë e ekranit, tastat funksionale.
- Të krijojnë ambientin e punës së *AutoCAD-2D*.
- Të ndërtojnë figurat gjeometrike nëpërmjet komandave të *AutoCAD-2D*.
- Të njohin metodat e editimit (kopjim, zhvendosje, fshirje, selektim).
- Të krijojnë dhe përcaktojnë shtresat, ngjyrat, tipat e vijave.
- Të njohin përdorimin e blloqeve të vizatimit të *AutoCAD-2D*.
- Të hartojnë tekstin dhe atributet e tjera në vizatim.
- Të plotësojnë vizatimin me të gjitha elementet dhe të nxjerrë në letër vizatimin (printimi).

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përdorimi i *AutoCAD-2D* në përpunimin e drurit”, kl.13 - 34 orë**



<b>Tema 1</b>	Njohuri për programin <i>AutoCAD-2D</i> që përdoret në përpunim druri	2 orë
<b>Tema 2</b>	Njohuri për krijimin e ambientit të punës së <i>AutoCAD-2D</i>	2 orë
<b>Tema 3</b>	Hartimi i vizatimeve nëpërmjet <i>AutoCAD-2D</i>	14 orë
<b>Tema 4</b>	Njohja me metodat e editimit (kopjim, zhvendosje, fshirje, selektim)	11 orë
<b>Tema 5</b>	Hartimi i teksteve dhe attributeve në vizatim	3 orë
<b>Tema 6</b>	Nxjerrja në letër e vizatimeve (Printimi)	2 orë

### **5. Lënda “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti” (L-09-267-12). Kl. 13 – 68 orë**

- **Synimet e lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl. 13. nxënësit duhet:

- Të analizojnë vizatimet e objekteve prej druri.
- Të shpjegojnë mënyrën e zbërthimit, detajimit të objektit sipas radhës, vendosjen e përmasave dhe mbipërmasave.
- Të shpjegojnë hartimin e kartës shoqëruese të detaleve.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së lëndës së drurit, me bazë druri dhe e materialeve të tjera sipas normativave përkatëse.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të kostos së objektit prej druri.
- Të përshkruajnë proceset përfundimtare të prodhimit të objektit prej druri, si marketimin, ambalazhimin dhe depozitimin e tij.
- Të përcaktojnë hapat e teknologjisë së prodhimit, në repart, fabrikë dhe anekse të tjera, sipas llojit të objektit prej druri apo gjysmë të gatshme si dhe të kapacitetit prodhues.
- Të interpretojnë mënyrën e sigurimit të lëndës së parë dhe materialeve të tjera sipas kushteve teknike.
- Të rendisin llojet e vozave sipas karakteristikave teknike, lëndës së parë, etj, duke përshkruar veçoritë e tyre.
- Të rendisin hapat teknologjike të prodhimit të vozave duke shpjeguar secilin proces në veçanti, si (zgjedhja e lëndës së parë, skicat, llogaritjet për kallëpe punimi e frezimi etj.)
- Të rendisin tipet e parketit sipas karakteristikave, duke përshkruar përdorimet e tyre.
- Të përshkruajnë hapat teknologjike të prodhimit të parketit duke përshkruar secilin proces.
- Të rendisin makinat e avancuara për përpunimin e drurit.
- Të shpjegojnë ndërtimin, gradimin, mënyrën e programimit të frezave kopjuese (CNC), makinave të montimit të pjesëve metalike, makinave skuadruese të pllakave dhe makinave borduese.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika e ndërtimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme me elemente projekti”, kl. 13. - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Analiza e prodhimit të objekteve prej druri	3 orë
<b>Tema 2</b>	Analiza dhe përpunimi i vizatimeve të objekteve prej druri	6 orë

<b>Tema 3</b>	Hartimi i kartës shoqëruese për prodhimin e objekteve prej druri	5 orë
<b>Tema 4</b>	Llogaritja e materialeve për prodhimin e objekteve prej druri	4 orë
<b>Tema 5</b>	Përcaktimi i kostos së prodhimit të objekteve prej druri	4 orë
<b>Tema 6</b>	Magazinimi i objekteve prej druri	3 orë
<b>Tema 7</b>	Teknologjia e prodhimit të objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme.	4 orë
<b>Tema 8</b>	Makineritë, pajisjet dhe materialet për prodhimin e objekteve prej druri apo gjysmë të gatshme	7 orë
<b>Tema 9</b>	Restaurimi i objekteve prej druri	3 orë
<b>Tema 10</b>	Prodhime speciale prej druri dhe vozat	6 orë
<b>Tema 11</b>	Teknologjia e prodhimit të vozave	8 orë
<b>Tema 12</b>	Teknologjia e prodhimit të parketit	7 orë
<b>Tema 13</b>	Makina të avancuara të përpunimit të drurit.	8 orë

## **6. Lënda “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”( L-09-268-12). Kl. 13 – 68 orë**

### **• Synimet e lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të tregojnë vetitë e avullit të ujit dhe ajrit të atmosferës si mjet tharës.
- Të tregojnë vetitë elastiko-plastike dhe shformimet që shfaqen gjatë tharjes te lënda drunore.
- Të tregojnë klasifikimin e dhomave, pajisjeve, makinave etj, që përdoren për tharjen e drurit, ashklave etj.
- Të dallojnë dhomat e tharjes me veprim periodik nga ato me veprim të pandërprerë.
- Të përshkruajnë funksionimin e pajisjeve që përdoren në dhomat e tharjes për rregullimin e parametrave të ajrit dhe kontrollin e tyre.
- Të tregojnë kriteret e zgjedhjes së regjimit të tharjes së lëndës drunore në tharëse dhe puna me të.
- Të përshkruajnë metoda të tjera tharjeje dhe të specifikojnë vecoritë e tyre.
- Të përshkruajnë tendencat kryesore të zhvillimit të tharjes së materialit drunor.
- Të tregojnë kërkesat bashkëkohore në teknikën e tharjes.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të kohës së tharjes sipas faktorëve që ndikojnë.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së prodhimitarisë vjetore në tharëse.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të sasisë të avullit të nevojshëm për tharje.
- Të përcaktojnë kriteret e zgjedhjes së mënyrës dhe metodës së tharjes.
- Të klasifikojnë mjetet e transportit të brendshëm.
- Të lexojnë skemat dhe mënyrën e përdorimit të makinave peshëngritëse, makarave dhe polispasteve.
- Të dallojnë skemën e punës së vinçave-urë nga ata të vincave-pirun.
- Të lexojnë skemën e punës dhe të shpjegojnë funksionimin e transportierëve me zinxhirë, me rrip, me pllaka dhe me rula.
- Të klasifikojnë transportin me shina.
- Të shpjegojnë funksionin e mjeteve lëvizëse mbi shina treni (platforma, vagona dhe truke).

- Të dallojnë llojet e transportit pneumatik.
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së sistemit grumbullues.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika e tharjes së drurit dhe transporti i brendshëm”, kl.13 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Vetitë e avujve të ujit dhe ajrit si mjet tharës	3 orë
<b>Tema 2</b>	Dukuritë fizike dhe vetitë e drurit gjatë tharjes	4 orë
<b>Tema 3</b>	Tharja natyrore dhe artificiale	6 orë
<b>Tema 4</b>	Regjimi në tharjen e drurit	4 orë
<b>Tema 5</b>	Metoda të tjera të tharjes të drurit	4 orë
<b>Tema 6</b>	Kërkesat bashkëkohore në teknikën e tharjes	4 orë
<b>Tema 7</b>	Cilesitë e tharjes, koha dhe prodhimtaria e tharëseve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Treguesit tekniko-ekonomikë të tharjes	4 orë
<b>Tema 9</b>	Transporti i brendshëm	3 orë
<b>Tema 10</b>	Makinat peshëngritëse	8 orë
<b>Tema 11</b>	Makina dhe instalime transporti me organe tërheqëse	8 orë
<b>Tema 12</b>	Makina dhe instalime transporti pa organe tërheqëse	8 orë
<b>Tema 13</b>	Teansporti pneumatik	8 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Zbërthimi i projektit të objekteve me bazë druri

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: III

Klasa: 13

<i>PERSHKUESI I MODULIT</i>	
Titulli dhe kodit	ZBERTHIMI I PROJEKTIT TE OBJEKTEVE ME BAZE DRURI (M-09-810-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbërthyer projektin e objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik.
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.
Rezultatet e të mësuarit (RM), Përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit zbërthimin e projektit të objekteve me bazë druri.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e objektit prej druri.</li><li>– Analiza e objektit prej druri.</li><li>– Interpretimi i vizatimeve të gatshme të objektit prej druri.</li><li>– Përcaktimi i normativës së materialit drunor.</li><li>– Përcaktimi i normativës së kimikateve.</li><li>– Përcaktimi i llojit dhe sasisë së aksesorëve metalikë.</li><li>– Përcaktimi i llojit të makinave që do të përdoren.</li><li>– Përcaktimi i radhës së punës.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e realizimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të zgjedhë objektin prej druri sipas kërkesës dhe vendit të përdorimit.</li><li>– Të analizojë objektin prej druri sipas ndërtimit, materialeve etj.</li><li>– Të interpretojë vizatimet e gatshme të objektit prej druri duke specifikuar ansamblet, nënansamblet dhe elementet përbërëse.</li><li>– Të përcaktojë normativën e materialit drunor sipas vizatimeve dhe tabelës së prerjes.</li><li>– Të përcaktojë normativën e kimikateve në tabelat përkatëse.</li></ul>

- 
- Të përcaktojë llojin dhe sasinë e aksesorëve metalikë sipas tabelës së materialeve ndihmëse.
  - Të përcaktojë llojet e mjeteve, pajisjeve dhe makinave që do të përdoren për realizimin e objektit;
  - Të përcaktojë radhën e punës sipas kartës teknologjike.

**RM 2 Nxënësi zbërthen vizatimet e objektit prej druri.**

***Përmbajtja***

- Zbërthimi i vizatimit të pamjes së përgjithshme të objektit prej druri.
- Përpunimi i vizatimit të projeksioneve ortogonale.
- Vendosja e përmasave në projeksionet ortogonale.
- Zbërthimi i objektit në pjesë të veçanta.
- Zbërthimi i objektit në detalet përbërëse.
- Paraqitja në vizatim e nyjeve, lidhjeve dhe bashkimeve.
- Vendosja e përmasave dhe mbipërmasave.
- Vizatimi i kallëpeve dhe shabllojeve.
- Kujdesi për veglat, pajisjet dhe vizatimet.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së vizatimeve të objekteve prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Të zbërthejë vizatimin e pamjes të përgjithshme të objektit prej druri sipas vendit ku do përdoret.
- Të vizatojë dhe të përpunojë projeksionet ortogonale të objektit prej druri sipas modelit.
- Të vendosë me saktësi sipas modelit përmasat në projeksionet ortogonale të objektit prej druri.
- Të zbërthejë në vizatim objektin prej druri në pjesë të veçanta ansamble dhe nënasnsamble.
- Të skicojë objektin në detalet përbërës sipas radhës.
- Të vizatojë nyjet e lidhjeve dhe bashkimeve sipas kërkesës.
- Të vendosë sipas normave përmasat dhe mbipërmasat në çdo pjesë, nyje dhe detal.
- Të vizatojë kallëpet dhe shabllonet për punime në makineri.
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe vizatimet e objektit prej druri.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së vizatimeve të objekteve prej druri.



### **RM 3 Nxënësi harton dokumentacionin teknik për objektin prej druri .**

#### ***Përmbajtja:***

- Hartimi i kartës shoqëruese për çdo detal të objektit prej druri.
- Hartimi i tabelës përmbledhëse të prerjes.
- Hartimi i planit kalendarik të punimeve me grafikun e fuqisë puntore.
- Plotësimi me afate kohore të planit kalendarik për çdo punim.
- Hartimi i grafikut të fuqisë punëtore.
- Përcaktimi i lëndës së drurit, prodhimit gjysmë të gatshëm.
- Hartimi i tabelës me lëndë ndihmëse.
- Përcaktimi i lëndëve ndihmëse.
- Përcaktimi i mënyrës së ambalazhimit të objektit prej druri.
- Përpilimi i certifikatës së cilësisë.
- Përcaktimi i kushteve të depozitimit dhe ruajtjes së objektit prej druri.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të hartojë kartën shoqëruese, sipas normave, për cdo detal të objektit prej druri, pllake sipas modeleve dhe shablloneve.
- Të hartojë tabelën përmbledhëse të prerjes sipas radhës së proceseve të punës.
- Të përcaktojë lëndën e drurit dhe materiale me bazë druri si kompensatë, rimeso, pllakë zdrukthi, fibre etj. sipas tabelës të prerjes.
- Të hartojë tabelën me lëndë ndihmëse sipas normativave të tyre.
- Të plotësojë në pasqyrën e planit kalendarik të punimeve llojet e punimeve me sasi të përkatëse sipas preventivit.
- Të zbërthejë çdo lloj punimi në orë pune specialist dhe punëtor duke përdorur manualët e preventivimit të punimeve të përpunimit të drurit dhe të kthejnë orët e njehsuara në ditë pune.
- Të plotësojë në pasqyrën e planit kalendarik afatet kohore për çdo punim duke ndjekur radhën e tyre.
- Të hartojë grafikun e fuqisë punëtore sipas të dhënave të pasqyrës së planit kalendarik të punimeve.
- Të përcaktojë sasinë e lëndëve ndihmëse sipas normativave në tabelë.
- Të përcaktojë mënyrën e ambalazhimit të objektit prej druri sipas normave dhe kërkesës.
- Të përpilojë certifikatën e cilësisë të objektit prej druri

sipas normave të caktuara.

- Të përcaktojë kushtet e depozitimit dhe të ruajtjes të objektit prej druri apo gjysëm të gatshëm prej druri.

#### **RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike.**

##### ***Përmbajtja:***

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e objektit prej druri.
- Kostot në punimet e objektit prej druri.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Përpunim druri”, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të Përpunim drurit gjatë prodhimit të objektit prej druri.
- Hartimi i preventivit për materiale në prodhimin e objektit prej druri.
- Përgatitja e faturës për procesin e kryer në prodhimin e objektit prej druri.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e objektit prej druri.
- Të përcaktojë koston në punimin e objektit prej druri;
- Të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- Të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- Të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh etj.);
- Të llogaritë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Përpunim druri”
- Të llogaritë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël përpunim druri gjatë prodhimit të objektit prej druri;
- Të përgatitë faturën për koston e objektit prej druri;
- Të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, në bazën prodhuese, punishte apo fabrika të përunimit të drurit
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për zbërthimin dhe përpunimin e projektit të objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik..



- 
- Mësuesi të organizojë edhe vizita në vënde ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e zbërthimit dhe përpunimit të projektit të objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik.
  - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, për proceset e zbërthimit dhe përpunimit të projektit të objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për proceset e zbërthimit dhe përpunimit të projektit të objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e zbërthimit dhe përpunimit të projektit të objekteve me bazë druri si dhe për të hartuar dokumentacionin teknik.
  - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë, repart, fabrikë.
  - Pajisje, vegla për vizatim, etj.
  - Material drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
  - Skica dhe vizatime të objektit të mobilerisë.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
- 



## 2. Moduli “Ndjekja e punimeve për ngritjen e repartit të përpunimit të drurit”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: III  
Klasa: 13

### PERSHKUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	NDJEKJA E PUNIMEVE PER NGRITJEN E REPARTIT TE PERPUNIMIT TE DRURIT	(M-09-811-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndjekur punimet për ngritjen e një reparti për përpunimin e drurit, për prodhimin e objekteve të mobilerisë ose prodhime gjysmë të gatshme.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), Përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi ndjek punimet përgatitore për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit.</b></p> <p><b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Ndjekja e zgjedhjes të vendit në përshtatje me thellësinë e ujrave nëntoksore.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të vendit në përshtatje me furnizimin me ujë, energji elektrike.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të vendit në përshtatje me dritën.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të vendit në përshtatje me rrugët.</li><li>– Ndjekja e ofert- kërkesës të tregut</li><li>– Ndjekja e analizës dhe përpunimit të skicës, vizatimit të planimetrisë.</li><li>– Ndjekja e përcaktimit të numrit të pajisjeve, makinave, dhe mjeteve të transportit.</li><li>– Ndjekja e përcaktimit të radhës së punës.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të specialisteve.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të furnizimit me lëndë të parë.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes të furnizimit me lëndë ndihmëse.</li><li>– Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve përgatitore për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e realizimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të ndjekë zgjedhjen e vendit, sipas normave, në përshtatje me thellësinë e ujrave nëntoksore.</li><li>– Të ndjekë zgjedhjen e vendit, sipas normave, në përshtatje</li></ul>	

- 
- me furnizimin me ujë dhe energji elektrike.
  - Të ndjekë zgjedhjen e vëndit në përshtatje me dritën.
  - Të ndjekë zgjedhjen e vëndit në përshtatje me rrugët jashtë dhe brënda repartit.
  - Të ndjekë analizën dhe përpunimin e skicës, vizatimit të planimetrisë të repartit, fabrikës.
  - Të ndjekë përcaktimin e numrit të paisjeve, makinave, mjeteve të transportit të nevojshme në repart, fabrikë në bazë të kapacitetit prodhues.
  - Të ndjekë përcaktimin e radhës së punës, që nga sheshi i depozitës të lëndës të parë deri te magazinimi i objektit.
  - Të ndjekë zgjedhjen e furnizimit, me lëndë të parë sipas distancës, leverdisë ekonomike etj.
  - Të ndjekë zgjedhjen e furnizimit me lëndë ndihmëse sipas cilësisë etj.
  - të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve përgatitore për ngritjen e një reparti të përpunimit të drurit.

**RM 2 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës për përgatitjen e sheshit të depozitës të lëndës të parë.**

***Përmbajtja:***

- Ndjekja e punimeve për përmirësimin e thellimit të ujrave nëntokësore.
- Ndjekja e kontrollit të shtresave të nevojshme mbi sipërfaqen e depozitës.
- Ndjekja e punimeve për desifektimin e sipërfaqes së depozitës.
- Ndjekja e punimeve të vendosjes së bazamenteve prej betoni.
- Ndjekja e bashkëpunimit për furnizimin me ujë të depozitës.
- Ndjekja e bashkëpunimit në përgatitjen e basenave të ruajtjes apo avullimit.
- Ndjekja e bashkëpunimit në vendosjen e mjeteve të transportit.
- Ndjekja e bashkëpunimit për vendosjen e ndonjë makine të nevojshme.
- Ndjekja e kujdesit për veglat, pajisjet dhe makinat.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në kryerjen e procesit të punës për përgatitjen e depozitës për punë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Të ndjekë punimet për përmirësimin e thellimit të ujrave nëntokësore sipas nivelit të kërkuar.
- Të ndjekë kontrollin e shtresave të nevojshme mbi

- sipërfaqen e depozitës në se janë sipas standarteve.
- Të ndjekë punimet për dezinfektimin e sipërfaqes të depozitës me kimikate kundër insekteve dhe kërpudhave.
- Të ndjekë punimet e vendosjes të bazamenteve prej betoni për vendosjen e stivave me material drunor.
- Të ndjekë dhe bashkëpunojë për furnizimin me ujë të depozitës të nevojshëm për basenat, spërkatje artificiale, furnizim të repartit etj.
- Të bashkëpunojë në përgatitjen e basenave të ruajtjes, apo avullimit dhe të tubave për spërkatje artificiale.
- Të ndjekë bashkëpunimin në vendosjen e mjeteve të transportit si vinca, ura tërthore, transportjerë, etj.
- Të ndjekë bashkëpunimin për vendosjen e ndonjë makine të nevojshme në depozitë, si sharë rrethore për shkurtim të lëndës të parë, etj.
- Të ndjekjë kujdesin për veglat, pajisjet dhe makinat.
- Të ndjekjë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në kryerjen e procesit të punës për përgatitjen e depozitës për punë.

### **RM 3 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës për përgatitjen e repartit të makinerisë.**

#### ***Përmbajtja***

- Ndjekja e kontrollit të sipërfaqes të repartit.
- Ndjekja e bashkpunimit për instalimet elektrike.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e instalimeve ngrohëse.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e makinave të përpunimit të drurit.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e makinave ndihmëse.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen paisjeve të tjera të nevojshme.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e bangove të punës.
- Ndjekja e kujdesit për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes të repartit të makinerisë për punë.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së repartit të makinerisë për punë.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të ndjekë kontrollin e sipërfaqes së repartit për shtrimin dhe nivelimin.
- Të ndjekë bashkpunimin sipas normave për instalimet elektrike të nevojshme.

- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e instalimeve të ngrohjen të repartit, si kaloriferë etj.
- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e makinave të përpunimit të drurit sipas teknologjisë.
- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e makinave ndihmëse, si makina e mprehjes të instrumentave, caprazit etj.
- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e bangove të punës sipas rradhës të proceseve.
- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen paisjeve të tjera të nevojshme, raftë, paisje kundra zjarrit, dihmë e shpejtë, etj.
- Të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes së repartit të makinerisë për punë.
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të repartit të makinerise për punë.

**RM 4 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës për përgatitjen e repartit të montimit.**

***Përmbajtja:***

- Ndjekja e bashkpunimit për kontrollin e sipërfaqes të repartit.
- Ndjekja e bashkpunimit për instalimet elektrike.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e makinave të montimit.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e makinave ndihmëse.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen paisjeve të transportit.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e bangove të punës.
- Ndjekja e bashkpunimit për vendosjen e rafteve të nevojshme.
- Ndjekja e bashkpunimit për instalimin e paisjeve në sektorin e lyerjes dhe llustrimit.
- Ndjekja bashkpunimit për përgatitjen e magazinës të produktit të gatshëm.
- Ndjekja e kujdesit për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes të repartit të montimit për punë.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të repartit të montimit për punë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të ndjekë bashkpunimin për kontrollin e sipërfaqes të repartit për shtrimin dhe nivelimin.
- Të ndjekë bashkpunimin për instalimet elektrike dhe



- tokëzimet e nevojshme.
- Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e makinave të montimit sipas skicës.
  - Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e makinave ndihmëse sipas teknologjisë.
  - Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e paisjeve të transportit si transportierë etj.
  - Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e bangove të punës sipas skicës.
  - Të ndjekë bashkpunimin për vendosjen e rafteve të nevojshme.
  - Të ndjekë bashkpunimin për instalimin e paisjeve në sektorin e lyerjes dhe llustrimit.
  - Të ndjekë bashkpunimin për përgatitjen e magazinës së produktit të gatshëm dhe paisjen e saj me aparate për matjen e parametrave të ajrit.
  - Të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes së repartit të montimit për punë.
  - të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të repartit të montimit për punë.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në vënde ku do të ngrihen punishte apo fabrika të përunimit të drurit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për të ndjekur ngritjen e punishtes apo fabrikës të përpunimit të drurit, të organizojë edhe vizita në vënde ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës, për të ngritur punishte apo fabrika të përunimit të drurit. Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, për ndjekjen e punimeve për të ngritur punishte apo fabrika të përunimit të drurit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për të ngritur punishte apo fabrika të përunimit të drurit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve për të ngritur punishte apo fabrika të përunimit të drurit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:
- Depozitë, repart, fabrikë.
- 





- 
- Paisje, makina, etj.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiali drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
  - Skica të planimetrisë të repartit, fabrikës, skema të vendosjes së basenave, paisjeve, makinave, transportierë etj.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Kompleti i veshjeve të punës.
-

### 3. Moduli “Ndjekja e punimeve për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PERSHKUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	<b>NDJEKJA E PUNIMEVE PËR PRODHIMIN E OBJEKTEVE PREJ DRURI OSE GJYSMË TË GATSHME</b>	(M-09-812-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndjekur punimet për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme prej druri.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), Përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për ndjekjen e punimeve përgatitore për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Ndjekja e përshtatjes të vendit të punës.</li><li>– Analiza e skicës të objektit.</li><li>– Zbërthimi dhe përpunimi i skicës.</li><li>– Ndjekja e përzgjedhjes të materialeve.</li><li>– Ndjekja zgjedhjes të veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e objektit.</li><li>– Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të ndjekë mënyrën e organizimit të vendit të punës.</li><li>– Të analizojë skicën e objektit sipas modelit të objektit.</li><li>– Të bashkëpunojë në zbërthimin dhe përpunimin e skicës me përmasa fikse duke u bazuar te modeli i objektit.</li><li>– Të ndjekë përzgjedhjen e materialeve të nevojshme sipas standartit.</li><li>– Të ndjekë zgjedhjen e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e objektit.</li><li>– Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e</li></ul>	

**RM 2 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës në makineri për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.**

***Përmbajta***

- Ndjekja e matjes dhe shënimit mbi material.
- Gradimi i makinës.
- Ndjekja e sharrimit të trupave.
- Ndjekja e shkurtimit të materialit drunor.
- Ndjekja e drejtimit të materialit në brinjë.
- Ndjekja e sharrimit të materialit në gjatësi
- Ndjekja e drejtimit të elementeve të objektit.
- Ndjekja e punimeve në makinën grosecë.
- Ndjekja e shkurtimeve të elementeve në përmasa fikse.
- Ndarja dhe shënimi i elementeve.
- Ndjekja e shpimit të elementeve.
- Ndjekja e thithëzimit të elementëve.
- Ndjekja e profilimit të elementeve.
- Ndjekja e tornimit, prerjes plane.
- Ndjekja e copëtimit të drurit në ashkla,
- Ndjekja e defibrimit dhe e rafinimit.
- Ndjekja e kontrollit të punimeve në makina.
- Ndjekja e rregullatve të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës në makineri për prodhimin e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Të ndjekë matjen dhe shënimin mbi material.
- Të gradojë makinën sipas procesit të punës.
- Të ndjekë sharrimin e trupave në gatër, sharrë shirit sipas modelit të prerjes.
- Të ndjekë drejtimin e materialit në brinjë sipas trashësisë në skicë.
- Të ndjekë sharrimin e materialit në gjatësi sipas skicës.
- Të ndjekë drejtimin e elementeve të objektit.
- Të ndjekë punimet në makinën grosecë.
- Të ndjekë shkurtimin e elementeve, sipas skicës, në përmasa fikse.
- Të ndajë dhe shënojë elementet sipas vendit në objekt.
- Të ndjekë shpimin e elementeve sipas përmasës në skicë.
- Të ndjekë thithëzimin e elementëve sipas përmasës në skicë.
- Të ndjekë profilimin sipas modelit të elementeve.

- Të ndjekë tornimin apo prerjen plane të trupave për prodhimin e rimesos teknike apo dekorative.
- të ndjekë copëtimin e drurit në ashkla për pllakë zdrukthi.
- të ndjekë defibrimin e ashklave të drurit dhe rafinimin e fibrave.
- të ndjekë kontrollin e punimeve të kryera në makina.
- të ndjekë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës në makineri për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

### **RM 3 Nxënësi kryen procese pune në makina të avancuara të përpunimit të drurit.**

#### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e makinës frezë kopjuese CNC.(makinë kontroll numerik) për punë.
- Programimi i makinës CNC.
- Lëshimi i makinës CNC.
- Punimi i pllakave apo detaleve në makinë.
- Programimi i makinës skuadruese.
- Lëshimi i makinës skuadruese.
- Skuadrimi i pllakave apo detaleve në makinë.
- Gradimi i grupeve të punës në makinën borduese.
- Programimi i makinës borduese.
- lëshimi i makinës borduese.
- Vendosja e bordurave në pllaka ose detale me makinë.
- Programimi i makinës së montimit të pjesëve metalike.
- Lëshimi i makinës së montimit të pjesëve metalike.
- Montimi i pjesëve metalike me makina.
- kontrolli i punimeve të bëra.
- Kujdesi për makinat e avancuara të përpunimit të drurit, paisjet dhe mjetet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës me makinat e avancuara të përpunimit të drurit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatitë makinën frezë kopjuese CNC.(makinë kontroll numerik) për punë sipas normave.
- Të programojë makinën CNC.sipas procesit të punës.
- Të lëshojë makinën CNC.për të kontrolluar programimin.
- Të punojë pllakat apo detalet në makinën CNC: sipas modelit..
- Të programojë makinën skuadruese sipas përmasave në skicë.

- Të lëshojë makinën skuadruese për të kontrolluar programimin.
- Të skuadrojë pllakat apo detalet, sipas modelit, në makinë.
- Të gradojë grupet e punës në makinën borduese sipas materialit bordues.
- Të programojë makinën borduese sipas procesit të punës.
- Të lëshojë makinën borduese për të kontrolluar programimin..
- Të veshi me bordurë pllakat apo detalet sipas modelit
- Të gradojë makinën sipas lloit të aksesorit metalik që do montojë.
- Të lëshojë makinën për kontrolluar programimin.
- Të montojë sipas modelit aksesorin metalik.
- Të kontrollojë punimet e bëra me makinat e avancuara të përpunimit të drurit.
- Të kujdeset për makinat e avancuara të përpunimit të drurit, paisjet dhe mjetet e punës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës me makinat e avancuara të përpunimit të drurit

**RM 4 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës të tharjes, ngjitjes dhe presimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.**

***Përmbajta***

- Përgatitja e makinës tharëse.
- Ndjekja e tharjes së materialit drunor.
- Kontrolli mbas tharjes.
- Ndjekja e përgatitjes së lëndës ngjitëse.
- Përgatitja e makinës së lyerjes me lëndë ngjitëse.
- Ndjekja e lyerjes me lëndë ngjitëse.
- Kontrolli i materialit të lyer
- Ndjekja e përgatitjes së materialit për presim.
- Përgatitja e presës për punë.
- Ndjekja e procesit të presimit
- Kontrolli mbas presimit.
- Ndjekja e trajtimit mbas presimit.
- Ndjekja e kujdesit për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes së proceseve të punës së tharjes, ngjitjes dhe presimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës së tharjes, ngjitjes dhe presimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***



Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatitë makinën tharëse për tharjen e elementeve prej druri, rimeso, zdrukthe, fibra, etj. sipas rastit në repart ose fabrikë.
- Të ndjekë tharjen e materialit drunor sipas parametrave në rregjim.
- Të kontrollojë, mbas tharjes, për arritjen e lagështirës përfundimtare.
- Të ndjekë përgatitjen e lëndës ngjitëse sipas recetave.
- Të përgatitë makinën e lyerjes me lëndë ngjitëse për punë.
- Të ndjekë lyerjen me lëndë ngjitëse të detaleve, ashklave, fibrave, etj. sipas normativës.
- Të kontrollojë materialin e lyer sipas cilësisë.
- Të përgatitë presën për punë sipas normave.
- Të ndjekë procesin e presimit sipas rregjimit të telajove, pllakave të zdrukthi, fibrës, rimesos, etj.
- Të kontrollojë cilësinë, sipas standartit, mbas presimit.
- Të ndjekë trajtimin mbas presimit si aklimatizimin, trajtimin termik të pllakës të fibrës etj.
- Të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes së proceseve të punës së tharjes, ngjitjes dhe presimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës të tharjes, ngjitjes dhe presimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

**RM 5 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të montimit-llustrimit dhe përfundimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.**

***Përmbajtja:***

- Matja dhe shënimi mbi elementet e përgatitura
- Ndjekja e skuadrimin të pllakave.
- Ndjekja e kalibrimit të pllakave.
- Ndjekja e hapjes të vrimave dhe foleve.
- Ndjekja e përgatitjes të kunjave bashkuese.
- Ndjekja e përgatitjes të sipërfaqes për lustrim.
- Ndjekja e zumparimit të sipërfaqes.
- Ndjekja e ngjyritimit të sipërfaqes.
- Ndjekja e lyerjes me pastë poliuretan.
- Ndjekja e tharjes të pastës poliuretan.
- Ndjekja e zumparimit të sipërfaqes.
- Ndjekja e pastrimit të sipërfaqes.
- Kontrolli dhe eliminimi i defekteve në sipërfaqe.
- Ndjekja e përgatitjes të materialit për lustrim.
- Ndjekja e lyerjes me poliuretan.
- Ndjekja e tharjes të shtresës të lustrës.



- Ndjekja e veshjes të brinjëve me plastikë.
- Ndjekja e montimit paraprak.
- Korigjimi i defekteve.
- Ndjekja e ngritjes të skeletit.
- Montime plotësuese.
- Ndjekja e montimeve plotësuese.
- Ndjekja e vendosjes të aksesorëve plotësues.
- Eliminimi i defekteve.
- Ndjekja e montimit perfundimtar të objektit.
- Ndjekja e ambalazhimit dhe magazinimit të objektit.
- Ndjekja e kujdesit për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes të proceseve të montimit Ilustrimit dhe përfundimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të montimit Ilustrimit dhe përfundimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të matë dhe të shënojë mbi elementet e përgatitura sipas skicës.
- Të ndjekë skuadrimin e telajove, pllakave të zdrukthit, fibrës , panelit, kompensatës, etj. sipas përmasës në skicë.
- Të ndjekë kalibrimin e pllakave me makina kalibruese, në trashësinë e kërkuar.
- Të ndjekë hapjen e vrimave dhe foleve sipas skicës.
- Të ndjekë përgatitjen sipas skicës të kunjave bashkuese.
- Të ndjekë përgatitjen e sipërfaqes të detaleve dhe pllakave për lustrim.
- Të ndjekë zumparimin sipas kërkesës në detalet dhe pllaka.
- Të ndjekë ngjyrosjen e detaleve, pllakave sipas modelit.
- Të ndjekë lyerjen me pastë poliuretan, për mbusjhjen e poreve sipërfaqen e detaleve, pllakave prej materiali drunor.
- Të ndjekë realizimin e tharjes të shtresës të pastës me poliuretan në paisjet përkatëse sipas rregjimit.
- Të ndjekë zumparimin e sipërfaqes të materialit drunor sipas shkallës të pastërtisë.
- Të ndjekë pastrimin e sipërfaqes mbas zumparimit.
- Të kontrollojë dhe eliminojë me kujdes defektet në sipërfaqe.
- Të ndjekë përgatitjen e materialit per lustrim sipas recetës përkatëse.
- Të ndjekë lyerjen me poliuretan të detaleve, pllakave sipas



normativës.

- Të realizojë tharjen e llustrës duke ndjekur rregjimin në paisjet përkatëse.
- Të ndjekë veshjen e brinjëve me plastikë sipas modelit.
- Të ndjekë, sipas rradhës, montimin paraprak.
- Të ndjekë korigjimin e defekteve gjatë montimit paraprak.
- Të ndjekë ngritjen e skeletit të objektit prej druri.
- Të ndjekë montimet plotësuese.
- Të ndjekë përgatitjen e sirtareve sipas skicës.
- Të ndjekë vendosjen e aksesorëve plotësues.
- Të eliminojë defektet e krijuara.
- Të ndjekë montimin perfundimtar të objektit.
- Të ndjekë ambalazhimin dhe magazinimin e objektit sipas kërkesës.
- Të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë kryerjes të proceseve të montimit, llustrimit dhe përfundimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të montimit, llustrimit dhe përfundimit për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme

#### **RM 6 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.**

##### ***Përmbajtja:***

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e objektit prej druri ose prodhime gjysmë të gatshme..
- Kostot në punimet e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Perpunim druri”, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të Perpunim drurit gjatë prodhimit të objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Hartimi i preventivit për materiale në prodhimin e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Përgatitja e faturës për procesin e kryer në prodhimin e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e objektit



- prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Të përcaktojë koston në punimin e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
  - Të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materiale.
  - Të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
  - Të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh etj.);
  - Të llogaritë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Përpunim druri”
  - Të llogaritë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël perpunim druri gjatë prodhimit të objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
  - Të përgatitë faturën për koston e objektit prej druri ose gjysmë të gatshme.
  - Të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për prodhimin e objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Të organizojë edhe vizita në punishte apo fabrika ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:
- Repart, fabrikë të prodhimit të objekteve prej druri ose gjysmë të gatshme.
-

- 
- Makina mjete të nevojshme për prodhimin e objektit të mobilerisë ose prodhime gjysmë të gatëshme.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiali drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
  - Skica e skema të objekteve prej druri.
  - Skema të linjave teknologjike të prodhimit të objektit të mobilerisë ose gjysmë të gatëshme prej druri.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Kompleti i veshjeve të punës.
-

#### 4. Moduli “Ndjekja e procesit të tharjes së lëndës së parë me bazë druri ”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: III  
Klasa: 13

##### PERSHKUESII I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDJEKJA E PROCESIT TE THARJES SE LENDES SE PARE ME BAZE DRURI	(M-09-813-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndjekur procesin e tharjes natyrore dhe artificiale të lëndës së parë me bazë druri.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi ndjek përgatitjen e vendit të punës për tharjen e materialit drunor, në dhoma, tunele, pajisje, makina.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Zgjedhja e mënyrës së tharjes.</li><li>– Zgjedhja e tipit të tharëses.</li><li>– Analiza e skicave të dhomës, pajisjes dhe makinës.</li><li>– Ndjekja e përcaktimit të radhës së punës.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes së materialeve.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes së pajisjeve të transportit të materialit drunor në tharëset përkatëse.</li><li>– Ndjekja e zgjedhjes së mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.</li><li>– Llogaritja e prodhimit të vjetore të pajisjes.</li><li>– Përcaktimi i numrit të tharëseve.</li><li>– Kryerja e llogaritjeve termike.</li><li>– Përcaktimi i kohës së tharjes.</li><li>– Zgjedhja e regjimit të tharjes.</li><li>– Organizimi i vendit të punës.</li><li>– Kontrolli i terrenit.</li><li>– Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të vendit të punës për realizimin e proceseve të punës të tharjen natyrore të materialit drunor në dhoma, tunele, pajisje dhe makina.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e realizimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të zgjedhë metodën e tharjes në lidhje me mjedisin.</li><li>– Të zbatojë kriteret e caktuara për zgjedhjen e tipit të</li></ul>	



- 
- tharëses sipas materialit apo kushteve që ka.
  - Të analizojë skicat e dhomës, pajisjes dhe makinës për të parë kapacitetin dhe kompletimin e tyre.
  - Të ndjekë përcaktimin e radhës së punës për tharjen natyrore të materialit drunor.
  - Të ndjekë zgjedhjen e materialeve sipas llojit të përmasave, lagështisë fillestare etj.
  - Të ndjekë zgjedhjen e pajisjeve të transportit të materialit drunor në tharëset përkatëse si transportierë, vagoneta, ura tërthore etj.
  - Të ndjekë zgjedhjen e mjeteve matëse dhe kontrolluese si termometra, manometra, anemometër, kalibër etj për përcaktimin e parametrave të mjetit tharës.
  - Të llogaritë prodhimtarinë vjetore të pajisjes tharëse.
  - Të përcaktojë numrin e tharëseve në funksion të prodhimtarisë vjetore.
  - Të kryejë llogaritje termike në dhoma apo pajisje të tjera tharëse të materialit drunor.
  - Të përcaktojë kohën e tharjes në funksion të karakteristikave të lëndës që do të thahet.
  - Të zgjedhë regjimin e tharjes sipas kriterëve të caktuara.
  - Të ndjekë organizimin e vendit të punës sipas rradhës;
  - Të kontrollojë terrenin e stivimit të materialit drunor sipas kushteve të caktuara.
  - Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të vendit të punës për realizimin e proceseve të punës në tharjen natyrore të materialit drunor në dhoma, tunele, pajisje dhe makina.

## **RM 2 Nxënësi ndjek kryerjen e proceseve të punës për përgatitjen e materialit drunor për tharje.**

### ***Përmbajtja***

- Përcaktimi i llojit të lëndës drunore që do thahet.
- Kontrolli i përmasave të materialit drunor
- Kontrolli i lagështirës fillestare të materialit drunor.
- Kontrolli e stivimit të materialit sipas normave të caktuara.
- Ndjekja e përgatitjes të provave treguese
- Ndjekja e vendosjes të provave treguese në stive sipas normave.
- Ndjekja e kujdesit për veglat, pajisjet dhe makinat.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në kryerjen e proceseve të punës për përgatitjen e materialit drunor për tharje.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Të përgatitë materialin drunor që mund të jetë dërrasë,

- rimeso, ashkla, fibra etj. për tharje.
- Të përcaktojë materialit drunor që do të thahet sipas llojit (ah,plep,meshteknë etj.).
- Të kontrollojë përmasat e materialit drunor në trashësi, gjerësi etj.
- Të kontrollojë lagështirën fillestare të materialit drunor me aparat matës të lagështirës.
- Të ndjekë stivimin e materialit sipas normave të caktuara.
- Të përgatitë provat treguese sipas kërkesave.
- Të vendosë provat në stivë sipas normave.
- Të përcaktojë kohën e tharjes duke patur parasysh karakteristikat e lëndës drunore dhe parametrat e mjetit tharës.
- Të përcaktojë regjimin e tharjes duke patur parasysh metodën e tharjes.
- Të ndjekë kujdesin për veglat, pajisjet dhe makinat gjatë përgatitjes të materialit drunor për tharje.
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune gjatë përgatitjes të materialit drunor për tharje.

### **RM 3 Nxënësi përgatit tharësen për punë.**

#### ***Përmbajtja***

- Lëshimi i kaloriferëve.
- Hapja e tubave të njomjes.
- Ngrohja paraprake e lëndës drunore.
- Vendosja në punë e kondesatorëve
- Vendosja në punë e ventilatorëve.
- Vendosja në pozicion 0 e aparateve matës të parametrave
- Vendosja e materialit në tharëse.
- Mbyllja hermetike e tharseve.
- Ndjekja e kujdesit për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes të tharëses për punë.
- Ndjekja e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes të tharëses për punë.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të lejojë kalimin e avullit në kaloriferët që ndodhen në dhomën, paisjen, makinën etj. në momentin e duhur.
- Të hapë tubat e njomjes për ngrohjen paraprake të dhomës, paisjeve të saj dhe materialit drunor.
- Të vendosë në punë kondesatorët për largimin e ujit.
- Të vendosë në punë ventilatorët për të rregulluar shpejtësinë e lëvizjes të ajrit në tharëse.
- Të vendosë në pozicion 0 aparatet matës të parametrave të mjetit tharës si termometra,anemometra,aparate të

- lagështirës etj.
- Te vendosë materialin në tharëse sipas normave.
- Të mbyllë në mënyrë hermetike tharësen.
- Të ndjekë kujdesin për pajisjet dhe instrumentet gjatë përgatitjes së tharëses për punë.
- Të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tharëses për punë.

#### **RM 4 Nxënësi ndjek procesin e tharjes natyrore.**

##### ***Përmbajtja:***

- Kontrolli i temperaturës të ajrit.
- Kontrolli i presionit të ajrit.
- Kontrolli i shpejtësisë të lëvizjes të ajrit.
- Kontrolli i lagështirës relative të ajrit.
- Kontrolli i defekteve që mund të shkaktohen.
- Kontrolli i mbulesave në stiva.
- Mbajtja e shënimeve për çdo matje.
- Kontrolli i lagështirës përfundimtare
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes së procesit të tharjes natyrore.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë temperaturën e ajrit të atmosferës me termometër.
- të kontrollojë presionin e ajrit të atmosferës.
- të kontrollojë shpejtësinë e lëvizjes të ajrit të atmosferës me anemometër.
- të kontrollojë lagështirën relative të ajrit.
- të kontrollojë defektet që mund të shkaktohen gjatë tharjes natyrore.
- të kontrollojë mbulesat e stivave sipas normave të caktuara.
- të mbajë shënime për çdo matjedhe kontroll të bërë.
- të kontrollojë lagështirën përfundimtare të materialit drunor.
- të ndjekë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes së procesit të tharjes natyrore.

#### **RM 5 Nxënësi ndjek procesin e tharjes artificiale të materialit drunor në dhoma, pajisje, makina.**

##### ***Përmbajtja:***

- Kontrolli i temperaturës së mjetit tharës.
- Kontrolli i presionit të mjetit tharës.
- Kontrolli i shpejtësisë të lëvizjes të mjetit tharës.
- Kontrolli i kohës së tharjes.

- Krahasimi i matjeve të parametrave të mjetit tharës me të dhënat e rregjimit.
- Mbajtja e shënimeve për cdo matje.
- Kontrolli i shformimeve gjatë tharjes.
- Marja e masave për evitimin e shformimeve.
- Kontrolli i lagështirës përfundimtare të materialit drunor.
- Realizimi i periudhës të ekuilibrit.
- Ndjekja e mirëmbajtjes të pajisjeve dhe instrumentave matës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes të procesit të tharjes artificiale

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të kontrollojë temperaturën e mjetit tharës me termometrën teknik.
- Të kontrollojë presionin e mjetit tharës me manometër.
- Të kontrollojë shpejtësinë e lëvizjes të mjetit tharës me anemometër.
- Të kontrollojë kohën e tharjes.
- Të krahasojë matjet e aparateve matës me të dhënat në tabelat e rregjimit të tharjes.
- Të mbajë shënime për cdo matje të bërë gjatë rregjimit për ta transmetuar te turni tjetër.
- Të kontrollojë shformimet që mund të krijohen gjatë tharjes me ndihmën e provëzave të kontrollit.
- Të marrë masat për evitimin e shformimeve në kohën e duhur.
- Të kontrollojë lagështirën përfundimtare të materialit drunor sipas kërkesës.
- Të kontrollojë shpërndarjen e lagështirës përfundimtare në seksion të lëndës drunore.
- Të realizojë periudhën e ekuilibrit po të jetë e nevojshme, sipas një rregjimi të caktuar.
- Të ndjekë mirëmbajtjen e pajisjeve dhe instrumentave matës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ndjekjes të procesit të tharjes artificiale.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përunimit të drurit me depozita të tharjes natyrore, dhoma, paisje, makina tharëse.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për tharjen e lëndës së parë, të organizojë edhe vizita në punishte apo fabrika ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.

- 
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për tharjen e lëndës të drurit. fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve për tharjen e materialit drunor, si dërrasë, rimeso, zdrukthe, fibra etj.
  - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart, fabrikë me dhoma, pajisje, makina për tharjen e lëndës së drurit.
  - Kompleti i pajisjeve për rregullimin e parametrave të mjetit tharës.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiali drunor, dërrasë, detale druri, rimeso, ashkla druri, fibra druri etj.
  - Skica e skemës të dhomave, paisjeve, makinave tharëse, mënyrës të stivimit, provëzave trëguese etj.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Kompleti i veshjeve të punës.
-



## 5. Moduli “Vizatime teknike të përpunimit të drurit me *AutoCAD*”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	<b>VIZATIME TEKNIKE TË PËRPUNIMIT TË DRURIT ME <i>AutoCAD</i></b>	(M-26-814-12)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar vizatime teknike të përpunimit të drurit me anë të programit <i>AutoCAD</i> .	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Përpunim druri”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi parapërgatit realizimin e vizatimit teknik të përpunim drurit me <i>AutoCAD</i>.</b> <b><i>Përmbajtja</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përzgjedhja e një objekti kompleks ose konceptimi i një ideje për një vizatim teknik kompleks.</li><li>– Analizimi i objektit/idesë që do të paraqitet me anë të vizatimit teknik në <i>AutoCAD</i>.</li><li>– Përcaktimi i parametrave të vizatimit teknik që do të përgatitet.</li><li>– Skicimi në letër (me dorë) i draftit të vizatimit teknik që do të realizohet me <i>AutoCAD</i>.</li><li>– Vënia në punë e kompjuterit.</li><li>– Hapja e programit <i>AutoCAD</i> specifik për vizatimin teknik që do të realizohet.</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Të përzgjedhin një objekt kompleks ose të konceptojë një ide të përshtatshme për një vizatim teknik kompleks.</li><li>– Të analizojnë drejt objektin/idenë që do të paraqitet me anë të vizatimit teknik në <i>AutoCAD</i> duke përcaktuar hapat e duhur.</li><li>– Të përcaktojnë parametrat e duhur të vizatimit teknik që do të përgatitet.</li><li>– Të skicojnë sipas rregullave në letër (me dorë) draftin e vizatimit teknik që do të realizohet me <i>AutoCAD</i>.</li><li>– Të vënë në punë kompjuterin duke respektuar radhën e veprimeve.</li></ul>	

- 
- Të hapin programin *AutoCAD* specifik për vizatimin teknik që do të realizohet duke respektuar radhën e veprimeve.

## **RM 2 Nxënësi realizon vizatimin teknik me *AutoCAD*.**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e një faqeje të re për vizatimin teknik që do të realizohet.
- Aplikimi i parametrave të kërkuar (formati, shkalla etj.).
- Vendosja e koordinatave.
- Vizatimi i objekteve të kërkuara (vijat, rrrathët, harqet, elipset, drejtkëndëshat, shumëkëndëshat, figurat komplekse etj.).
- Realizimi i shtresave, llojeve dhe trashësive të ndryshme të vijave.
- Përdorimi i efekteve të ndryshme në vizatim.
- Ngjyrosjet dhe hijet.
- Aplikimi i seksionimeve.
- Dhënia e përmasave dhe tolerancave.
- Shkrimi i teksteve dhe simboleve.
- Editimi i vizatimit teknik (selektimet, prerjet, zhvendosjet, kopjimet, ndryshimi i madhësisë etj.).
- Aplikimi i filtrave.
- Përgatitja e dokumentit për printim.
- Printimi i dokumentit.
- Ruajtja e dokumentit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të përgatitin një faqe të re për vizatimin teknik që do të realizohet duke respektuar radhën e veprimeve.
- Të aplikojnë sipas rregullave parametrat e kërkuar (formatin, shkallën, etj.).
- Të vendosin sipas rregullave koordinatat.
- Të realizojnë vizatimin e objekteve të kërkuara (vija, rrrathë, harqe, elipse, drejtkëndësha, shumëkëndësha, figura komplekse etj.) duke respektuar radhën e veprimeve.
- Të realizojnë vizatimin e shtresave, llojeve dhe trashësive të ndryshme të vijave duke respektuar radhën e veprimeve.
- Të aplikojnë sipas rregullave efektet e ndryshme në vizatim.
- Të realizojnë ngjyrosjet dhe hijet e kërkuara sipas shenjave dalluese përkatëse.
- Të realizojnë seksionimet e kërkuara sipas shenjave dalluese përkatëse.
- Të vendosin përmasat dhe tolerancat e sakta në vizatim.
- Të shkruajnë tekstet dhe simbolet e kërkuara.

- Të bëjnë sipas rregullave editimin e vizatimit teknik (selektime, prerje, zhvendosje, kopjime, ndryshim madhësie etj.).
- Të aplikojnë sipas rregullave filtrat.
- Të përgatitin sipas rregullave dokumentin për printim.
- Të printojnë sipas rregullave dokumentin.
- Të ruajnë sipas rregullave dokumentin.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasën ose laboratorin e praktikës së kompjuterave.
- Mësuesi\instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të veprimeve në kompjuter për realizimin e vizatimeve teknike të përpunim drurit me programin *AutoCAD*.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për përgatitjen, realizimin dhe printimin e vizatimeve teknike të përpunimit të drurit me programin *AutoCAD*, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Mësuesi\instruktori duhet të nxisë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë ose laborator kompjuterash.
  - Kompjuterat personalë me programin *AutoCAD*.
  - Objekte të ndryshme që do të vizatohen.
  - Printer.
  - Fomate letrash për vizatime teknike.
  - Manual i përdorimit të programit *AutoCAD*.
- 

